



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.1, datë 12/03/2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT,
LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIE 00002 SERIAL,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.3, DATË 27.02.2020, “LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR”, TË SUBJEKTIT
“DËSHMITARËT E JEHOVAIT”

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr.00002 serial “Leje për përdorim burimi ujor nëntokësor”, miratuar me Vendim Nr.3 datë 27.02.2020, të subjektit “Dëshmitarët e Jehovahit”, me vendndodhje: Njësia Administrative Kashar, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit:

X= 480163.82; Y= 4579002.43; Z= 67.5 m; (KRGJSH)

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime të ndryshme (sanitar).

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 0.0868 \text{ l/sek}$

$Q_{\text{mes-vjet}} = 0.0868 \text{ l/sek}$

Volumi i shkarkimit të ujrave të përdorura: $Q = 7.3 \text{ m}^3/\text{ditë}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU ISHËM

EMILJAN JANI

